



Publikimi i kryqëzuar për përfaqësim

Njohje me integrimin efektiv të mediave sociale



Ky udhëzues është licencuar nën *Licencën e Krijtjve Komons 3.0*




Ka përfitime të shumta nga kjo qasje. E para është se tërhiqni më shumë vizitorë, që mund të jenë përkrahës të mundshëm, për fushatën tuaj të blogut. Gjithashtu, ka efekt në rritjen e jetëgjatësisë së artikujve të blogut dhe web-faqes tuaj, duke gjeneruar një cikël të ndarjes dhe të promovimit, që mund të vërehet shumë lehtë nga kërkuesit si p.sh. Google.



Ky është shembull i një publikimi të vendosur në platforma të ndryshme



Kjo taktikë për fushatë elektronike kërkon njohje elementare të një numri të madh të softverëve dhe web aplikacioneve, siç janë makro dhe [mikro shërbimet për blogim](#), web-faqet për shënime sociale dhe për rrjeta sociale. Ju duhet të krijoni nga një profil në secilin prej këtyre web shërbimeve në mënyrë që ato të mund të ndërveprojnë në mes vete, ashtu që ndryshimet dhe linket tuaja të paraqiten menjëherë dhe në mënyrë automatike posa t'i keni publikuar. Aq më tepër, siç është paraqitur në ilustrimin e mëposhtëm, jo vetëm që mund ta shtoni web-faqen dhe blog feed-in tuaj në shënimet tuaja në [Facebook](#), ([Facebook](#) Notes), por mund të shtoni edhe feed-e të tjera, si p.sh. linke deri te videot tuaja në Youtube, fotografitë tuaja në Flickr, [prezantimet](#) dhe podkastet (materialet tuaja multimediale në Internet) tuaja.




Për këtë shembull, supozoj se tanimë keni profile në [Twitter](#) dhe [Facebook](#) (përndryshe, krijoni ato). Në fillim do të regjistrohemi për të krijuar një profil në [Twitterfeed](#) dhe të krijojmë një feed të ri që do ta përcjellë çdo publikim nga blogu apo web-faqeja juaj në Twitter. Që kjo të funksionojë, [do t'ju duhet një profil OpenID](#) që të mund të regjistroheni për shërbimin (nëse nuk keni [krijoni një tani](#)).

[Twitterfeed](#) publikon sa më shumë karaktere të mundshme nga titulli dhe përshkrimi, gjersa ta arrijë kufirin e Twitterit prej 140 karaktereve, së bashku me link të shkurtuar deri te publikimi juaj origjinal. Ka përkrahje për [TinyURL](#) dhe shërbime të tjera alternative për shkurtrim të URL-ve, që marrin një link të gjatë dhe e shndërrojnë atë në link të shkurtë që mund të klikohet. Gjithashtu keni mundësi t'ia shtoni një prefiks "tweet-eve" tuaja, që është shumë e dobishme nëse planifikoni të importoni më shumë se një RSS feed në profiling tuja në Twitterfeed. Shembuj të prefikseve janë: "E re në blogun tim:", "Videoja ime e fundit në Youtube:", "Fotografia ime e fundit në Flickr:", etj.].



Si ta publikoni blogun apo web-faqen tuaj në Twitter

- 2 Pasi të jeni lajmëruar në [Twitterfeed](#), klikoni në butonin "Create new Twitter feed" 
- 3 Në faqen e ardhshme shënioni detajet tuaja për lajmërim në Twitter (emrin e shfrytëzuesit dhe fjalëkalimin), e pastaj shënioni linkun RSS feed të blogut apo web-faqes suaj. Kini kujdes që të jenë të selektuara fushat "include item link" dhe "Active".

Create new twitter feed

Username: Password: [test twitter authentication](#)

RSS Feed URL: [test rss feed](#)

Update frequency: Post up to new updates each time
[Update Frequency describes how often we check your feed for new posts. The very first time we check, we post the most recent entry only, and after that, any new entries since the last time we checked.]

Include ...

Include item link (if unchecked, sends tweet without the link) Shorten link through

Post new items based on

Prefix each tweet with: (max. 20 characters)

Filter by keywords: [no filter]

Active (if unchecked, this twitterfeed will be inactive, and will not post to twitter)

- 4 Pasi ta keni krijuar për herë të parë, mundeni gjithmonë ta ndryshoni feed-in tuaj, ta bëni atë joaktiv, ose bile edhe ta fshini.





Ndryshojeni statusin tuaj në Facebook nëpërmjet Twitter-it



Tanimë kur blog publikimet tuaja paraqiten në Twitter, hapi i ardhshëm është ta aktivizoni [Aplikacionin Twitter Facebook](#) i cili i dërgon 'tweets-at' tuaj në Facebook. Pasi ta keni shtuar aplikacionin Twitter, aktivizojeni opcionin që i lejon Twitter-it që në mënyrë automatike ta ndryshojë statusin tuaj në profiling tuaj në Facebook. Poqese e përdorni [MySpace](#), [Twitter Sync](#) ju lejon që ta sinkronizoni statusin e disponimit tuaj nëpërmjet Twitter-it.



FeedBlitz bën edhe një hap tjetër përpara duke bërë dërgesë automatike të email-it dhe porosive instante (Instant Messaging - IM)

Përderisa Twitter-i e ndryshon statusin tuaj në Facebook, [FeedBlitz](#) (shërbim partner Web 2.0 i [Feedburner](#), që ju ndihmon ta optimizoni shpërndarjen e përmbajtjes suaj) bën edhe një hap përpara duke bërë dërgesë automatike të e-mailit dhe porosive instante (IM), duke i dërguar parajmërimet dhe ndryshimet tuaja në Twitter, [Skype](#), [AOL Instant Messenger](#), [MSN Messenger](#) dhe [Yahoo! Messenger](#). Edhe pse RSS feed-et janë shumë të përhapura, shumë njerëz akoma i preferojnë e-mail buletinet. Shfrytëzimi i shërbimeve Web 2.0, siç janë [Feedburner](#) ose [FeedBlitz](#), që i automatizojnë proceset e publikimit, dërgimit dhe parapagimit, ju ndihmojnë që me lehtësi të arrini te parapaguesit tuaj.

Start your FREE subscription to ...

1. Enter your email address:

Get your updates via:

- Email
- Skype
- AOL Instant Messenger
- Microsoft Messenger
- Twitter
- Yahoo! Messenger

FeedBlitz Subscription Options



Disa argumente kundër përdorimit të publikimit të kryqëzuar



Shumica e argumenteve që janë bërë [kundër teknikës së publikimit të kryqëzuar](#) janë të sakta. Shndërrimi i aspektit të linkimit të [Twitter-it](#), [Plurk-ut](#) dhe shërbimeve të tjera për mikroblogim në një formë të platformës për publikim për fushatën tuaj, nga ana e miqve, pasuesve dhe parapaguesve tuaj, mund të konsiderohet si spam dhe e tepërt. Ata mund të mërziten duke hasur në ndryshimet dhe publikimet e njëjta në blogun tuaj, profilin tuaj në Twitter, [Facebook](#), RSS, etj.

Sidoqoftë, përdorimi i drejtë dhe inteligjent i kësaj teknike do të ofrojë rezultate të dukshme nëpërmjet procesit të ndarjes në Internet. Shqyrtimi i mënyrave të drejta dhe inovative për shfrytëzim të kësaj teknike mund të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të gjithmbarshëm të strategjisë për të qenë në kontakt me publikun tuaj, e në të njëjtën kohë duke zvogëluar redundancën. Mos harroni se sikur edhe të gjitha taktikat tjera, edhe kjo taktikë mund të mos ia shtojë vlerën fushatës tuaj elektronike ose ta zvogëlojë atë, varësisht nga ajo se si e shfrytëzoni.




Një shembull i mirë se si të shfrytëzohet teknika e publikimit të kryqëzuar

Disa [aktivistë digjitalë](#) nga vende me censurë mjaft të përhapur të Internetit e shfrytëzojnë këtë taktikë për ta njoftuar në mënyrë automatike publikun e tyre për “pasqyrat” e reja të web-faqeve dhe blogojeve të tyre të bllokuara apo të censuruara. Prandaj, në vend të humbjes kohë për të dërguar e-maila dhe t’i mbushin kutitë e e-mailit të parapaguesve të tyre, aplikacionet si p.sh. [Facebook](#), Twitter e kryejnë punën për t’i paraqitur URL-të e reja deri tek web-faqet e tyre, duke i anashkaluar censuresit dhe duke e dërguar porosinë.



Ju lutemi kontrolloni udhëzuesit tanë të tjerë 2.0 për Përfaqësim



[Gjeobombardimi](#) është një nga teknikat që mund të shfrytëzohet për të siguruar shpërndarje efektive të video fushatave tuaja nga YouTube nëpërmjet aplikacioneve për harta të Google siç janë Google Maps dhe Google Earth. Tani mund t’i shikoni videot tuaja me etiketë gjeografike brenda aplikacioneve Google Earth dhe Google Maps. Çdo video e YouTube-it me etiketë gjeografike do të paraqitet kur të jetë e aktivizuar shtresa Youtube në Google Earth/Maps [[lexoni më shumë...](#)]

